



Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional

STANDARDI I PROFESIONIT
Teknik i Izolimit të Ndërtesave

Sektori: Ndërtimtari

Kodi: 7124, Punëtorët për izolim, sipas (KPK 08, Prishtinë 2016), Versioni në gjuhën Angleze (7124 Insulation workers), ISCO 08, ILO

Data e aprovimit:

Ky standard profesional është zhvilluar me mbështetje të Projektit KSV020- një projekt i financuar nga Qeveria e Luxemburgut menaxhuar nga Zyra Lux Development dhe Projektit “Promovimi i Qendrave të Kompetencës në Kontekst të Reformës së Arsimit dhe Aftësimi Profesional në Kosovë.

Ekipi për zhvillimin e Standardit të Profesionit Teknik i Izolimit të Ndërtesave

Moderator: Ramë Likaj

Koordinatorë i ekipit: Inxh.Dipl. Ndërt. Mehmet Hetemi

Anëtarët e grupit: Inxh.Dipl.Ark. Meral Hallaqi Radoniqi, Inxh.Dipl.Ark. Uran Kyçyku

Referencat:

1. STANDARDI I PROFESIONIT NË NDËRTIMTARI. Moduli: *Muratorët dhe Punëtorët e Ngjashëm*. Autorë: Dren Peli, MSc can. në Ndërtimtari (Bau Academy- Kosovë) , Norbert Kees (Gjermani- Amberg Bau GmbH & Co.KG) , Dr.Georg Scharl (Shoqata e Zejtareve te Bajernit- Mynih), Max Stadler (Shoqata e Zejtareve te Bajernit- Mynih), Heike Christof (Zyra qendrore për arsimim të vazhdueshëm në industrinë e zejtarisë- Berlin, SCIVET- Projekt).
Standard i profilit i zhvilluar nga Bau Academy në bashkëpunim me Shoqatën e Ndërtimtarëve të Kosovës dhe asaj të Gjermanisë, e mbështetur nga Zyra qendrore për Arsimit të vazhdueshëm në industrinë e zejtarisë (Projekti SCIVET) – Berlin).
2. STANDARD ZANIMANJA. Zanimanje: IZOLATER/IZOLATERKA. Centar za stručno obrazovanje u Crnoj Gori
<http://www.cso.edu.me/Produkcija%20CSOa/Forms/AllItems.aspx?RootFolder=%2FProdukcija%20CSOa%2FStandardi%20zanimanja%2F10%20%2D%20Arhitektura%2C%20geodezija%20i%20gradjevinartsvo&InitialTabId= Ribbon%2EDocument&VisibilityContext=ÉSSTabPersistence>
3. The Institute for Apprenticeships and Technical Education.
<https://www.instituteforapprenticeships.org/apprenticeship-standards/industrial-thermal-insulation-technician/>
4. Materials of the vocational education “Specialist for Building Insulation”
<http://www.skills-energy.eu/material/>
Description-Curriculum-Vocational-Training-Specialist-for-Building-Insulation.pdf
<http://www.skills-energy.eu/ep-content/uploads/2013/02/Description-Curriculum-Vocational-Training-Specialist-for-Building-Insulation.pdf>
5. STANDARD NA ZANIMANJE. Zanimanje: FASADER. Ministerstvo za trud i socijalna politika u Republika Severna Makedonija. Rešenje br.08-5782/15
6. KLASIFIKIMI I PROFSIONEVE NË KOSOVË - KPK 08. Ministria e punës dhe mirëqenies sociale- Republika e Kosoves. Prishtinë 2016
<https://kpk.rks-gov.net/>
7. ZHVILLIMI DHE VERIFIKIMI I STANDARDEVE PROFESIONALE. Autoriteti Kombëtar I Kualifikimeve- Kosovë. EU KOSVET V - Zhvillimi i Sigurimit të Cilësisë, Akreditimit dhe Zhvillimi i AKK & KKK në Kosovë. Nr. i Projektit: 2009/216-809
8. UDHËZUES PËR ZHVILLUESIT E STANDARDEVE TË PROFESIONIT (SP)-
<http://www.alledkosovo.com/publications/download/3-Udh%C3%ABzues-dhe-sigurimi-i-cil%C3%ABsis%C3%AB/Udh%C3%ABzues-p%C3%ABr-zhvilluesit-e-standardeve-t%C3%AB-profesionit5.pdf>

1 Përshkrimi i profesionit

Nxënësi që merr arsimin profesional sipas një modeli të standardizuar kryen në mënyrë të pavarur instalime, riparime dhe zëvendësime të materialeve të ndryshme izoluese në ndërtesa për të ndihmuar kontrollin dhe ruajtjen e temperaturave në ndërtesa, kontrollin dhe depërtimin e zërit si dhe mbrojtjen nga lagështia dhe kondenzi dhe aftësohet që nën mbikëqyrje të zbaton projekte të izolimit në ndërtesa. Në përgjithësi nxënësi:

- *Përzgjedh mjetet, pajisjet dhe makineritë e duhura për aplikim të izolimit.*
- *Interpreton dokumentacionin teknik dhe përpilon skica, skema për të kryer punimet e izolimit në ndërtesa.*
- *Dallon vetitë, karakteristikat e materialeve për izolim dhe përdorimin e duhur.*
- *Përzgjedh dhe përgatitë materialin izolues dhe substratet e nevojshme për izolim.*
- *Kalkulon koston për realizimin e punëve të izolimit.*
- *Përdorë materialet izolues në elementet ndërtimore sipas projektit dhe specifikimeve*
- *Përdorë materialet hidroizolues në elementet ndërtimore sipas projektit dhe specifikimeve*
- *Përdorë shtresat mbrojtëse të izolimeve.*
- *Përdorë materialet e izolimit gjatë rindërtimit dhe renovimit të ndërtesave.*
- *Mirëmban mjetet e punës.*
- *Zbaton masat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.*

Përveç aftësive dhe njohurive teknike me të cilët nxënësi do të plotësojë kompetencat profesionale, ai/ajo përmes projekteve të nxënies, do të pajiset edhe me kompetencat kryesore personale dhe sociale :

- *Të kërkojnë, vlerësojnë dhe përdorin burime dhe dokumentacione teknike.*
- *Të shpjegojnë dhe hartojnë udhëzime mbi funksionimin dhe të bëjnë prezantime teknike me teknika të ndryshme.*
- *Të zbatojnë planifikime detyrash dhe punësh, të organizohen dhe punojnë në grup si dhe të komunikojnë siç duhet me klientin.*
- *Të përdorin teknologjinë e informimit dhe komunikimit për qëllime profesionale, dhe t'i zbaton parimet kryesore të menaxhimit të cilësisë.*

2 Përshkrimi i Funksioneve

Nr.	Funksioni	Përshkrimi i funksionit
1	Analiza, planifikimi dhe organizimi i punës	Ky funksion ka të bëjë me: planifikimin për fillimin e instalimit të shtresave izoluese, analizën e objektit ku do të punohet, furnizimin e materialeve në vendet e punës, sjelljen e veglave të punës. Aktivitetet kyçe të këtij funksioni janë: • Inspekton vendin e punës • Radhitë proceset e punës • Cakton afatet kohore për realizimin e punës
2	Përgatitja e vendit për kryerjen e punimeve	Ky funksion ka të bëjë me : punët përgatitore për të plotësuar kërkesat e instalimit të materialeve izoluese, përzgjedhjen e materialeve të duhura për punë, përzgjedhjen e veglave të punës, Përdorë masat për qasje dhe mënyrë të sigurte në punë. Aktivitetet kyçe të këtij funksioni janë: • Përzgjedh mjetet dhe materialet e nevojshme për realizimin e punës • Përgatit vendin e punës • Përdorë masat për qasje dhe mënyrë të sigurte në punë në përputhje me rregulloret • Mirëmban vendin dhe mjetet e punës
3	Llogaritjet për kryerjen e punimeve të izolimit	Ky funksion ka të bëjë me: llogarinë e shpenzimit të materialit, shërbimit dhe kalkulimin e çmimit si dhe mban shënime për punët e kryera dhe shpenzimet e materialit. Aktivitetet kyçe të këtij funksioni janë: • Llogarit shpenzimet e furnizimit me material • Llogarit çmimet e shërbimit • Krahason punët e kryera dhe shpenzimet e materialit
4	Punimi i izolimit termik / akustik	Ky funksion ka të bëjë me: aplikimin e shtresave termoizoluese ose zë izoluese sipas rregullave dhe procedurave teknike në elementet konstruktive si: dysheme, themele, xokull, mure të jashtme, mure të brendshme, kulme të rrafshëta, kulme të pjerrëta, terasa, etj. Aktivitetet kyçe të këtij funksioni janë: • Shqyrton materialet për izolim termik/akustik . • Përgatitë bazën / sipërfaqet para izolimit termik/akustik. • Kryen izolimin termik/akustik sipas Sistemeve njohura aplikuese në pozicione të ndryshme në ndërtesë.

		Kryen Shtresat të ndryshme Finale / mbrojtëse mbi izolim termik/akustik.
5	Punimi i hidroizolimit	Ky funksion ka të bëjë me: aplikimin e shtresave hidroizoluese sipas rregullave dhe procedurave teknike në elementet konstruktive si: Dysheme, themeleve, Xokull, Mure te Jashtme, Mure të brendshme, Kulme te Rrafshëta, Kulme të Pjerrëta, Terasave, etj. Aktivitetet kyçe të këtij funksioni janë: - Shqyrton materialet për hidroizolimi - Përgatitë bazën / sipërfaqet para hidroizolimit - Kryen hidroizolimin sipas Sistemeve njohura aplikuese në pozicione të ndryshme në ndërtesë - Kryen shtresat të ndryshme mbrojtëse mbi hidroizolim
6	Siguria, shëndeti në punë dhe mbrojtja e mjedisit	Ky funksion ka të bëjë me: njohuritë dhe praktikat në lidhje me shëndetin, rreziqet, masat e sigurisë që kandidatët duhet të zbatojnë në vendin e punës si dhe zbatimin e masave mbrojtëse të ambientit dhe deponimin e materialeve dhe mbeturinave të ndërtimit sipas udhëzuesve dhe rregulloreve. Ajo mbulon përgjegjësitë ndaj vetes, të tjerëve, aseteve dhe mjedisit. Aktivitetet kyçe të këtij funksioni janë: - Kontribuon për një ambient të sigurtë dhe të shëndetshëm në punë - Kontribuon në evitimin e rreziqeve shëndetit dhe sigurisë - Përdor pajisjet , veglat dhe materialet në mënyrë të sigurt - Mirëmban pastërtinë në hapësirën e punës

1. Funkzioni: Analiza, planifikimi dhe organizimi i punës (mobilizimi per pune)

Ky funksion ka të bëjë me: punët përgatitore për fillimin e instalimit të shtresave izoluese, analizën e objektit ku do të punohet, furnizimin e materialeve në vendet e punës, sjelljen e veglave të punës.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Inspekton vendin e punës	Specifikat e vendit të punës janë të njohura, si vendi, kushtet ambientale, etj. Pozicioni i objekteve të autoriteteve të ndryshme është i njohur. Vend furnizimet janë të identifikuara	Interpretimi i dokumentacionin teknik ndertimore Njohuri bazike për normativat në ndertimari për punët e izolimit Njohuri në përdorimin e kompjutorit dhe programeve perkatese aplikative.	Zberthimi i aktiviteteve të izolimit Përpilimi i planit dinamik për punët e izolimit Organizimi i resurseve njerezore (ekipeve punuese) për implementimin e izolimit	Bën zgjidhjen e problemeve në situata të ndryshme Komunikon me të tjerët në mënyrë profesionale Tolerant I vetëdijshëm për punën që kryen dhe ambientin punues Punë ekipore Komunikativ
Radhitë proceset e punës	Nen-aktivitete të izolimit janë të zberthyera kronologjikisht Plani punuar i shfrytëzimit të resurseve njerezore konform dinamikës së punës. Plani i kordinimit me aktivitete tjera (aktivitet paralele apo vijuese) është i definuar	Njohuri të përgjithshme organizative.		
Cakton afatet kohore për realizimin e punës	Plani dinamik për implementimi të punëve të izolimit i definuar Afatet kohe për furnizim me material janë të identifikuara dhe përgatitura			

--	--	--	--	--

Kushtet e realizimit të funksionit: Zyre, inventarë, materiale shpenzuese, kompjutor me programe perkatese aplikative.

Kërkesat e vlerësimit:

Evidenca e performancës – evidencë se personi mund të planifikojë dhe organizojë punën e tij në vende reale të punës ose evidencë që të identifikojë afatet kohore për lloje të ndryshme të punëve.

Evidenca e njohurive – Test me shkrim/gojë për të demonstruar njohurinë dhe kuptimin për planifikim dhe organizimin e punëve të izolimit.

2. Funkcioni: Përgatitja e vendit për kryerjen e punimeve (organizimi i vendit të punës në punishte)

Ky funksion ka të bëjë me : punët përgatitore për të plotësuar kërkesat e instalimit të materialeve izoluese, përzgjedhjen e materialeve të duhura për punë, përzgjedhjen e veglave të punës, Përdorë masat për qasje dhe mënyrë të sigurte në punë.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Përzgjedh mjetet dhe materialet e nevojshme për realizimin e punës	Materialet e nevojshme për implementimin e izolimit janë të definuara Veglat dhe mjetet e nevojshme për implementimin e izolimit janë të definuara	Interpretimi i dokumentacionin teknik ndertimore Një karakteristikat e materialeve për izolim Një karakteristikat e veglave dhe mjeteve që nevojitet për izolim Një menyrat e vendosjes dhe perforcimit të skelerise Një menyrat e sigurimit dhe shenjeimit të vendpunishtes.	organizimi i punishtes për aplikimin e izolimit Vendosja dhe perforcimi i skelerise Deponimi dhe ruajtja adekuate e materialit për izolim.	Punë ekipore Komunikativ Aftësi personale Njohja e gjuhëve të huaja Komunikon me të tjerët në mënyrë profesionale Tolerant I vetëdijshëm për punën që kryen
Përgatit vendin e punës	Vendpunishtja është e sigurt për punë Rrethojat dhe shenjat tjera informuese janë të vendosura Materiali është i depunuar në vend përkatës Mjetet dhe pajisjet për punë janë të pozicionuara në mënyrë të duhur dhe të sigurte			

	Skeleria eshte e vendosur ne menyre përkatëse			
Mirëmban vendin dhe mjetet e punës	Materiali ruhet sipas specifikave të materialit Veglat dhe mjetet e punës jane te pastuara dhe te mirembajtura. Ambienti i punës mbahet i paster gjate dhe pas cdo aktiviteti.			

Kushtet e realizimit të funksionit:

Zyre e punes , vend pune, kompjutore, mjete per vizatim..Mjetet e nevojshme

Vegla për lexim dhe matje të projektit: Laps, Metër, Vizore, Këndmatës

Vegla për montim të skeleve: Metër, Çekan, Set çelësash-fiso poligon, Çelës papagall, Niveletë, Dara, Veshje sigurie në punë (rrip sigurimi me krahë, kaskë pune, doreza, maskë, syza mbrojtëse) .

Kriteret e vlerësimit:

Evidenca e performancës: evidencë se personi mund të plotësojë kërkesat e izolimeve, të përshkruaj veçoritë dhe dukuritë e materialeve izoluese, përcaktimin e mjeteve të nevojshme, mirëmbajtjen e veglave të punës si dhe zgjedhjen e mjeteve mbrojtëse dhe siguroese.

Evidenca e njohurive: Test me shkrim dhe gojë që vërteton se nxënësi ka një kuptim të qartë të kërkesave të punës.

3. Funkzioni: Llogaritja për kryerjen e punimeve të izolimit.

Ky funksion ka të bëjë me: llogarinë e shpenzimit të materialit, shërbimit dhe kalkulimin e çmimit si dhe mban shënime për punët e kryera dhe shpenzimet e materialit.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Llogarit shpenzimet e furnizimit me material	Sasite e llogaritur e materialit te nevojshëm per implementimin e aktivitetit. Kosto e definuar e furnizmit të materialit Kosto e deinuar transportit te materialit Kosto e definuar e deponimit te materialit	Njohuri bazike të metodave kalkuluese Njohuri të metodave të matjeve teknike Njohuri të interpretimit te përshkrimit te materialit Njohuri të karakteristikave te materialieve	Kalkulimi i sasive dhe cmimit te materialit per aktivitetet e izolimit Percaktimi i sasise se angazhimit njerezore per implementimin e aktiviteve te izolimit Kalkulimi i cmimit te sherbimeve per implementimin e izolimeve	Aftësi personale Komunikon me të tjerët në mënyrë profesionale Tolerant I vetëdijshëm për punën që kryen Punë ekipore Komunikativ Vlerësim dhe vetëvlerësim
Llogarit çmimet e shërbimit	Numri i punetoreve te gjysmekualifikuar dhe të pakualifikuar është i definuar Numri i oreve/diteve totale per punetore që nevoiten per kryerjen e punëve është i përcaktuar Definim i shpenzimit te furnizimit apo amortizimit te veglave, paisjeve dhe makinerise qe perdoret	Njohuri në përdorimin bazike të programeve për vizatim teknik Njef veglat, paisjet dhe makineritë që nevioten për punet e kërkuara		

Kushtet e realizimit të funksionit:

Zyre e punës , vend pune, kompjutore, kalkulatorë, standarde për organizimin e punëve dhe përcaktimin e resurseve njerësore.

Kriteret e vlerësimit:

Evidenca e performancës: vëzhgim i performancës në kushte reale të punës

Evidenca e njohurive: Test me shkrim i njohurive, bashkëbisedë profesionale

4. Funkzioni: Punimi i izolimit termik / akustik

Ky funksion ka të bëjë me: aplikimin e shtresave termoizoluese ose zë izoluese sipas rregullave dhe procedurave teknike në elementet konstruktive si: dysheme, themele, xokull, mure të jashtme, mure të brendshme, kulme te rrafshëta, kulme të pjerrëta, terasa, etj.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Shqyrton materialet për izolim termik/akustik .	Materiali i nevojshëm për implementimin e aktivitetit është i definuar. Mjetet e duhura dhe paisjet e duhura për implementimin e aktivitetit janë të përvaktuara Mënyra e deponimit të të materialit në punishte konform specifikate është e definuar Afatet e përdorimit të materialeve janë konform të dhënave të produktit.	Kupton sistemin e izolimit Dallon llojet e ndryshme të materialeve Njohuri themelore të fizikës së ndërtimit Njohuri mbi mënyrat e deponimit dhe rrajtjes së materialit.	Planifikimi i vendit të punës Përcaktimi i veglave dhe mjeteve të punës Organizimi i ekipit punues Aplikimi i shtresave mbrojtëse Aplikimi i izolimit termik në ndërtesa Aplikimi i izolimit akustikë në hapësira specifike, si hotele, teatro, kinema, etj. d	Lexueshmëri të fokusuar Vlerësimi dhe vetëvlerësimi Komunikimi Të menduarit logjik Punë në grup Vendimmarrës Organizativ Manifeston guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësisë. Mbledh dhe përpunon informata Bashkëpunues Shkathtësi operative
Përgatitë bazën / sipërfaqet para izolimit termik/akustik.	Veglat e duhura për përgatitjen e bazës janë përdorur Materialet përkatëse për lyrjen e bazës janë përdorur Korrigjimet e nevojshme në vendit të pjesës ku bëhet izilimi janë bërë Baza është aplikuar sipas kërkesave	Njohuri për , karakteristikat e materialeve për izolime termike. Njohuri për karakteristikat e materialit për izolime akustike Njohuri për veglat dhe paisjet e duhura për implementimin e izolimeve termike dhe akustike.		
Kryen izolimin	Materiali dhe vegalt e duhura per			

termik sipas sistemeve njohura aplikuese në pozicione të ndryshme në ndërtesë	impelemtnimin e izolimit janë të përcaktuara Perforcimet e nevojshme per vendosjen e materialit izolues janë të vedosura Materiali per izolim është i pergatitur. Izolimi termik është i aplikuar në elementet e jashtme të strukturës/objektit , si psh. (; nën themele, xokull, dysHEME, fasadë, kulme të rrafshëta dhe të pjerrëta, mure të brendshme, tavane, ballkone e terasa, etj.) Elementet e izoluara janë të përgatitura për aplikimin e shtresave tjera të parapara Hapësirat specifike rreth dritareve, midis mureve, dysHEMEve dhe tavaneve (fugave), depërtimeve etj. Izolohen.	Njohuri mbi mënyrat e përgatitjes së materialit.		Aftësi korrigjimi të gabimit Durim, përqendrim dhe kontroll
Kryen izolimin akustik të objekteve dhe hapësirave specifike	Materiali dhe vegalt e duhura per impelemtnimin e izolimit akustik janë të përcaktuara. Perforcimet e nevojshme per vendosjen e materialit izolues akustik janë të vedosura Materiali per izolim akustik është i pergatitur. Izolimi akursitk është i aplikuar në hapësië			

	sipas kërkesave specifike.			
Kryen shtresat të ndryshme finale / mbrojtëse mbi izolim termik/akustik	Materiali dhe vegalt e duhura per impelemtnimin e shtresave mrojtëse janë të përcaktuara. Shtresa mbrojtëse/finale është e vendorur mbi material Përzgjedh materiale dhe mënyra për mbrojtje të përkohshme të shtresës finale	Interpreton masat nga vizatimet në materialet për përdorim Përvetëson materialin dhe përcakton teknikën e vendosjes duke përdorë teknikat dhe veglat e duhura Njeh kompozimin e materialeve Realizon shtresat finale mbi izolim Realizon mbrojtjen e shtreses finale		

Kushtet e realizimit të funksionit:

Vend i punes i sigurtë

Deponi e perkatëse në punishte per ruajtjen e materialit gjatë punës

Skeleri perkatëseMjetet e nevojshme

Vegla dhe Makineri elektrike

Vegla: Prerëse, Laps,Vizore metalike, Kënd matës metalik, Sharrë, Mistri, Niveletë, Rrafshuese, Çekan, Dara, Furçë, Përforcues të izolimit, Kaçavidë, Plumbçe me fije për kontroll të vertikalitetit, Pistoletë per shumë .

Makineri elektrike: Mikser për përzierje, turjelë elektike, flex elektrikë dore, Fshesë me vakum, Trapan, Pajisje për spërkatje të izolimit shkumë me kompresor ajri.

Kriteret e vlerësimit:

Evidenca e performancës: evidencë se personi shqyrton vizatimin e punës, dallon llojet dhe karakteristikat e materialeve izoluese, dallon elementet e fizikës ndërtimore, përzgjedhë makinat dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e procesit të punimit dhe finalizimit të Izolimeve duke zgjedhur regjimin e duhur të punës, zgjedh instrumentet përkatëse prerëse, rrafshuese e shtanguese dhe pajisjet e nevojshme montim / instalim bazuar në vizatime të detajuara.

Evidenca e njohurive: Test me shkrim, demonstrim praktik i funksioneve dhe kriterëve të performancës, aktivitete gjatë orëve mësimore, etj

5. Funkcioni: Punimi i hidroizolimit

Ky funksion ka të bëjë me: aplikimin e shtresave **hidroizoluese** sipas rregullave dhe procedurave teknike në elementet konstruktive si: dysheme, themeleve, xokull, mure te jashtme, mure të brendshme, kulme te rrafshëta, kulme të pjerrëta, terasa, etj.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Shqyrton materialet për hidroizolim	. Materiali i nevojshëm për implementimin e aktivitetit është përcaktuar në përputhje me specifikat. Mënyra dhe kushtet e deponimit të materialit në punishte konform specifikimeve teknike janë të definuara. Afatet e përdorimit të materialeve janë konform të dhënave të produktit.	Kupton sistemin e hidroizolimit Dallon llojet e ndryshme të materialeve Njohuri mbi mënyrën e deponimit të materialit në punishte	Planifikimi i vendit të punës Përcaktimi i veglave dhe mjeteve të punës Organizimi i ekipit punues Aplikimi i shtresave mbrojtëse Aplikimi i hidroizolimit në ndërtesa Përgatitë materialet për aplikim	Lexueshmëri të fokusuar Vlerësimi dhe vetëvlerësimi Komunikimi Të menduarit logjik Punë në grup Vendimmarrës Organizativ Manifeston guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësisë. Mbledh dhe përpunon informata Bashkëpunues Shkathtësi operative
Përgatitë bazën / sipërfaqet para hidroizolimit	Sipërfaqja ku implementohet sistemi i hidroizolimit është e përgaditur paraprakishtë konform zgjidhjes teknike dhe specifikimit teknik të materialit hidroizolues. Gjendja ekzistuese e sipërfaqes për izolim përmbushë kërkesat e cilësisë Materiali bazë është përcaktuar. Metodologjia për ekzekutim të punimeve është e përcaktuar konform zgjidhjes teknike, projektitspecifikimeve teknike te materialit dhe kushteve ne terren.	Njohuri për karakteristikat e materialeve. Njohuri për veglat dhe pajisjet e duhura për implementimin e hidroizolimeve. Njohuri mbi mënyrën për përgaditjen e sipërfaqes për implementim të materialit bazë.		

	Përdorimi i veglave dhe mjeteve të nevojshme dhe të përshtatshme. Shtresa bazë e hidroizolimit e zbatuar në përputhje me kërkesat dhe cilësinë e specifikuar në projekt.	Njohuri mbi karakteristikat e materialit bazë. Njohuri mbi përgaditja e materialit bazë.		Aftësi korrigjimi të gabimit Durim, përqendrim dhe kontrollë
Kryen hidroizolimin sipas sistemeve të njohura aplikuese në pozicione të ndryshme në ndërtesë	Matjet teknike janë realizuar. Metodologjia për ekzekutim të punimeve është e përcaktuar konform zgjidhjes teknike, projektit, specifikimeve teknike të materialit dhe kushteve në terren. Përdorimi i veglave dhe mjeteve të nevojshme dhe të përshtatshme. Shtresa e hidroizolimit e zbatuar në përputhje me kërkesat dhe cilësinë e specifikuar në projekt.	Njohuri për veglat dhe pajisjet e duhura për implementimin e materialit bazë. Përdorimi i pajisjeve për matje Grafika bazike inxhinjerie Përgaditja e materialeve për implementim të shtresës së hidroizolimit Njeh llojet, karakteristikat e materialit dhe teknikat e punës dhe përdorimin e veglave të duhura për vendosjen e hidroizolimit në pozicion		
Kryen shtresat të ndryshme mbrojtëse mbi hidroizolim.	Matjet teknike janë realizuar. Materiali për mbrojtje të hidroizolimit është përcaktuar në përputhje me zgjidhjen teknike, projektin dhe specifikimet teknike të materialit. Metodologjia për ekzekutim të punimeve është e përcaktuar konform zgjidhjes teknike,	Realizon përforcimet konform rregullave dhe vizatimeve Njeh kompozimin e materialeve		

	projektit, specifikimeve teknike te materialit dhe kushteve ne terren. Përdorimi i veglave dhe mjeteve të nevojshme dhe të përshtatshme.	Përvetëson teknikën e vendosjes së materialit		
--	--	--	--	--

Kushtet e realizimit të funksionit:

Vend i punes i sigurtë

Deponi e perkatëse në punishte per ruajtjen e materialit gjatë punës

Mjetet e nevojshme

Vegla dhe Makineri elektrike

Vegla: Laps, Vizore metalike,metër, Prerëse, Niveletë, Fshesë për pastrimin e substratit të betonit, Furçë, enë për aplikimin e veshjeve bazë dhe masave bituminoze, Mistri për aplikimin e masave izoluese, Kova për veshje bituminoze të ftohtë dhe bitum të nxehtë, Brenner - ndezës për saldimin e shiritave izolues, Roller-rulete manual për palosjet e hekurosjes, Çekiç per gozhda për fiksime të elementeve te forta të hidroizolimit , Prerës për shiritat izolues, Kaldaja/kazan për ngrohje të gazit butan ose naftë, Pistoletë për silikon/ngjitës.

Makineri elektrike: Mikser për perzirje, Fshesë me vakum, Paisje për sperkatje të hidroizolimit me kompresor ajri.

Kriteret e vlerësimit:

Evidenca e performancës: evidencë se personi shqyrton vizatimin e punës, përzgjedhë makinat dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e procesit të punimit dhe finalizimit të izolimeve duke zgjedhur regjimin e duhur të punës, zgjedh instrumentet përkatëse prerëse, rrafshuese e shtanguese dhe pajisjet e nevojshme montim / instalim bazuar në vizatimeve të detajuara.

Evidenca e njohurive: Test me shkrim, demonstrim praktik i funksioneve dhe kriterëve të performancës, aktivitete gjatë orëve mësimore, etj

6. Siguria, shëndeti në punë dhe mbrojtja e mjedisit

Ky funksion ka të bëjë me: njohuritë dhe praktikat në lidhje me shëndetin, rreziqet, masat e sigurisë që kandidatët duhet të zbatojnë në vendin e punës si dhe zbatimin e masave mbrojtëse të ambientit dhe deponimin e materialeve dhe mbeturinave të ndërtimit sipas udhëzuesve dhe rregulloreve. Ajo mbulon përgjegjësitë ndaj vetes, të tjerëve, aseteve dhe mjedisit.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Kontribuon për një ambient të sigurtë dhe të shëndetshëm në punë	Vendpunishtja është inspektuar dhe është bërë vlersimi i rreziqeve. Është përpiluar Plani për Mbrojtje dhe Siguri në Punë. Pajisjet personale mbrojtëse në përputhje me planin për mbrojtje dhe siguri në punë Plani për mbrojtje dhe siguri në punë zbatohet	Njohuri bazike lidhur me mbrojtjen dhe sigurinë në punë Përdorimi i pajisjeve personale mbrojtëse Njohuri për rrezikun nga pajisjet dhe veglat e punës	Identifikon rreziqet potenciale me saktësi Përdor pajisje , vegla dhe materiale në mënyrë të sigurt Ofron ndihmën e parë në rast të lëndimeve Menaxhon situatat e rënda për rreziqet	I përshtatshëm për punë ekipore I kujdesshëm Komunikativ Fleksibil Tolerant I arsyeshëm
Kontribuon në evitimin e rreziqeve për shëndetin dhe sigurinë	Trajnimet lidhur me rreziqet dhe masat që duhet të merren lidhur me mbrojtjen dhe sigurinë në punë kryhen sipas planifikimit Shenjat e informimit dhe orientimit në punishte janë të vendosura sipas Planit për mbrojtje dhe siguri në punë	Njohja e shenjave të informimit dhe orientimit	Trajton mbeturinat në mënyrë të sigurtë sipas karakteristikave të saj	I vetëdijshëm për punën që kryen Njohja e gjuhëve të huaja Shkathtësi të mira në komunikim në gjuhën zyrtare me klient për planin e

	Plani emergjent zbatohet në perpikëri në rast rreziku. Lëndimet në punë, aksidentet e ndryshme raportohen me perpikëri te organet përgjegjëse relevante.			kryerjes së punimeve
Përdor pajisjet , veglat dhe materialet në mënyrë te sigurtë	Veglat e punës dhe pajisjet përdoren në mënyrë adekuate dhe të përshtatshme. Materiali është i deponuar në përputhje me specifikimet teknike të produktit dhe në përputhje me Planin për siguri dhe mbrojtje në punë. Transporti horizontal dhe vertikal i materialeve me pajisje adekuate dhe në përputhje me Planin për siguri dhe mbrojtje në punë. Pajisjet dhe veglat e punës inspektohen në mënyrë të rregullt			
Mirëmban pastërtinë në hapësirën e punës	ëHapsirat e punës dhe vendpunishtja janë të pastruara Mbeturinat transportohen me pajisje dhe mjete të sigurta konform Planit për mbrojtje dhe siguri në punë. Mbeturinat deponohen në punishte përkohsishtë në lokacionin dhe pajisjet konform Planit për mbrojtje dhe siguri në punë.			

	Mbeturinat transportohen dhe deponohen në deponi të aprovuara me mjete dhe pajisje adekuate.			
--	--	--	--	--

Kushtet e realizimit të funksionit:

Vend i punës i sigurtë

Deponi e perkatëse në punishte për ruajtjen e materialit gjatë punës

Mjetet e nevojshme

Mjetet personale mbrojtëse dhe pajisjet për ndihmën e parë.

Kriteret e vlerësimit:

Evidenca e performancës: evidencë se si realizohen aktivitetet për zbatimin e masave të sigurisë në punë, ruajtjes së shëndetit dhe të ambientit, të cilat grumbullohen përmes vëzhgimit të kandidatit duke i bërë këto aktivitete situata reale të punës. Kontrollimi i ambientit të punës/listë .

Evidenca e njohurive: Test me shkrim dhe bashkëbisedim profesional për të demonstruar njohuri dhe shkathtësi për të zbatuar e masat e sigurisë në punë dhe ruajtjes së ambientit